

Isuf Sefolli, Kryetar i Këshillit, Bashkia Has

Isuf Sefolli ka lindur më 28 shkurt 1967,në Krumë.Gjatë viteve 1982-1986 kreu shkollën e mesme të përgjithshme në qytetin e Krumës. Më pas vazhdoi studimet e larta në vitet 1986-1990, Instituti i Lartë Pedagogjik në Shkodër,dega Matematikë-Fizikë.Fillimisht ka punuar mësues në fshatrat Letaj,Fajza,Vranisht. Gjatë viteve 1992-1995 mësues tek gjimnazi Krumë.Më tej 1995-1997 Komisariati i policies Has,1997-2014 mësues gjimnazi Krumë,2014-2017 aktivitet privat, 2017 e në vazhdim mësues në gjimnazin e Krumës. Mban titullin “ Mësues Mjeshtër “. Që nga viti 2007 është zgjedhur anëtar i Këshillit Bashkiak të Krumës.Anëtar i përhershëm i komisionit të arsimit në Këshillin Bashkiak të Krumës.Aktualisht Kryetar i Këshillit, Bashkia Has.